

**PROCESVERBAL**

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./N 01/23 Nr. ifaq/Br/str./No.pg 77

Data/Datum/Date 30.3.2023

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit e mbajtur më 28.4.2023 (e premte), me fillim në orë 10:00. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **Defrim Kalexhiu**. Në fillim konstatoi se ka kuorum për mbajtjen mbledhjes.

**Kryesuesi:** Fillmisht, përvendetje për të gjithë! I nderuar kryetar i Komunës, zt. **Smajl Latifi**, nënkyetar zt. **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtore të drejtive komunale, zyrtarë, përfaqësues të KFOR-i medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit, kjo është seanca e katërt (4) për këtë vit kalendarik. Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill, për këtë seancë, ka përgatitur këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P- 71510057-02240-1, zona kadastrale - Rahovec;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2022 në 2023;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim - ndryshimit të vendimit 01 Nr. 352/3, i datës 9.4.1986 mbi rivlerësimin dhe rikategorizimin e zonës së mbrojtur të "Kanioni i Drinit të Bardhë";
6. Shqyrtimi i raportit tre - mujor finansiar, janar - mars 2023;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë P- P-71510008-00266-0, në zonën kadastrale Hoçë e Madhe;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i planit komunal të veprimit për Riintegrin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrin e të Huajve në Komunën e Rahovecit;
10. Shqyrtimi i raportit finansiar buxhetor i NPL – Stacioni i Autobusëve – Rahovec;
11. Shqyrtimi i raportit të punës tre - mujore të KRM – Ekoregjioni.

**Shtesë:**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i veudimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës; (Kjo pikë ndërlidhet me piktën e shtafë të rendit të ditës);
2. Shfuqizimi i vendimit 01 Nr.48/23 dt. 30.3.2023 për riparcelizim të parcelave në zonën kadastrale - Rahovec;
3. Shfuqizimi i vendimit 01 Nr.54/23 dt. 30.3.2023 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit të fshatit Kramovik;

#### **4. Shfuqizimi i vendimit 01 Nr.55/23 dt. 30.3.2023 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë.**

**Kryesuesi:** Atëherë, përshëndetje për të gjithë, afër meje e kam bashkëpunëtorin e DEMOS-it, me të cilët komuna  
Rahovecit do të bashkëpunojë në 10 muajtë e ardhshëm për monitorimin e seancave dhe për përzgjedhjen e  
anëtarit më aktiv të kuvendit komunal për këtë vit.

**Naim Cahani:** Atëherë, përshëndetje për kryetarin, nënkyetarin, ekzekutivin, anëtarët e kuvendit dhe për të  
Pranishmit në seancë. Qëllimi i këtij prezantimi ka të bëjë me vlerësimin e performancës së juaj si anëtarë të  
Kuvendit komunal. Në bashkëpunim me kryesuesit e kemi parë të arsyeshme ta bëjmë këtë prezantim, sepse  
vlerësimi fillon nga muaji maj i këtij viti deri në muajin shkurt 2024. Për qëllim është rrija e llogaridhënieve dhe  
performancës më të mirë të një këshilltari komunal duke e rritur rolon e tyre si përfaqësues, ligjvënës dhe  
mbikëqyrës. Me prezencë fizike do ta bëjmë monitorimin gjatë çdo seance si dhe monitorimin online, përmes  
jetit social facebook. Vlerësimi do të bëhet në 3 kategori vlerësuese me gjithsej 9 indikatorë për të gjithë  
kuvedarët, përveq shesafe të grupit. sepse ata gjatë gjithë kohës janë në prezantime, me kërkesa të ndryshme dhe  
kshtuqë nuk janë në pjesë të vlerësimit.

**Kryesuesi – Faleminderit** për prezantimin Naim! Fillimi i kemi marrë informatën prej KDI-së, menjëherë e  
kemi shpreh gatishmërinë për këtë gjë. duke marrë parasysh qëllimin e fuqizimit dhe zhvillimit të transparencës në  
asamble komunale. Fillojmë me seancë ... (me leximin e rendit të ditës). Poashtu, për këtë seancë i kemi edhe pesë  
propozime shtesë, ku tre prej tyre kanë të bëjnë me shfuqizim sepse MAPL, dje i ka kthyer dhe ne duhet t'i  
shfuqizojmë brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj. Keini edhe dhënen e betimit të kuvendares së re, Florida  
Bajraktari. Pika tjeter shtesë ka të bëjë me një lëshim teknik. sepse pikës së 7-të duhet t'i shtohet edhe vendimi për  
formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave. Nëse dikush prej anëtarëve të kuvendit ka diçka për të thënë?...

**Burim Krasniqi:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje ekzekutiv, monitorues, media dhe gjithë ju prezent. Te  
pikat shtesë që janë për shfuqizime besoj që ka qenë e udhës që ta kemi materialin përpara, të jemi në dijeni se çka  
po shfuqizojmë. Një pyetje për drejtorin e finansave rrëth pikës 4 të rendit të ditës, ta kemi një arsyeshmëri pak më  
të plotë rrëth bartjcs së injeteve.

**Kryesuesi:** Faleminderit Burim! Sa për informacion, dokumentet për rishqyrtim nga MAPL-ja, kanë ardhur dje,  
10 minuta para orës 10:00, besoj që sot gjatë seancës do t'ju përcjellim fizikisht aryetimet e MAPL-së.

**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për kryetarin, drejtorët. Sa i përket dokumenteve të  
kthyera nga MAPL-ja, mirë është të kemi informatë për të gjitha që gjërat që i procesojmë dhe ato që ndodhin,  
mos të jemi me dilema sepse shumë janë bërë këtë shfuqizime, përkundër asaj që kemi shumë jurista.

**Rasim Fazliu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për juve, kryetarin, nënkyetari, anëtarët e kuvendit komunal,  
drejtorët dhe të gjithë të pranishmit. Shqetësimi im ka të bëjë me atë që në pothuajse në çdo mbledhje na vijnë  
pikat e rendit të ditës; të cilat nuk e kanë materialin përcjellës, e kam fjalën për disa pika të rendit të ditës. Kur të  
vijnë pikat shtesë, konkretisht për këtë mbledhje, nga sekretaria e kuvendit kanë ardhë dje, unë mendoj që ato pika  
duhet të janë të gatshme në Komitetin për Politikë dhe Financa, komiteti i shqyrton dhe më pastaj na përcjellin  
neve. E ftoj kryetari që t'u thotë drejtoreve që materialin ta bojnë gati me kohë dhe të mos kemi raste të tillë.

**Kryesuesi:** Faleminderit Rasim! Vërejtje me vend, shpresojmë që do të merret parasysh edhe nga ekzekutivi edhe  
nga KPF-ja.

**Kryetari:** Faleminderit kryesues i kuvendit! Nënkyetar, të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë, përfaqësues të  
KFOR-it. Shqetësimet që u paraqitën nga Burimi. Sefa dhe Rasimi, janë të arsyeshme. Por, ata që janë më me  
përvojë e dinë shumë mirë, që ndonjëherë bëhem peng të procedurave. Vendimet në këtë rast dje kanë ardhur dhe  
këtë nuk po e vërdori për shfajësim. Kërkoij mirëkuptim dhe kopjet fizike do t'i keni për pak minuta. Është shumë

e vertetë që duhet të diskutohen pikat në KPF-ja, mirëpo, këto tri pika nuk kemi pasur shansë t'i diskutojmë aty sepse, siç ju thashë, dje pasdite kanë ardhë.

**Bejtullah Deliu:** Pershëndetje kryesues, kryetar, nënkyetar, drejtorë, kolegë. Sa e vërejtja te parafolësit e mi, është e vërtetë që meterialet nga drejtoritë përkatëse vazhdimi shi mungojnë dhe nuk janë komplete, kjo është evidente.

**Burim Krasniqi:** Sa i përket pikave për shfuqizim, duhet të jemi në dijeni se çka jemi duke shfuqizuar me anë të materialit, nuk gjykova ka ardhë më herët apo me vonesë, po, çka po shfucizojmë. Nuk mora përgjigje pse pikën katër duhet ta kemi në rend dite? Tjetër, kryetar, sa i përket performancës, 70% e saj është prej asamblesë komunale.

**Kryetari:** Bejtë, zakonisht ata brenda dy javë duhet të na dërgojnë konfirmimin e ligjshmërisë, kryesisht MAPL-ja. Por, në kuend komunal, janë disa vendime në të cilat përfshihen disa ministri, pikërisht, këto janë arsyet e vonesave dhe konfirmimi mund të vijë pas dy muajve. Në praktikat e mëhershme janë bërë shumë herë që pika të caktuara të futen në rend dite shpejt e shpejt, për shkak të afatave dhe procedurave, për këtë arsyë mund të vijmë deri te mungesa e materialeve.

Te vendimi për bartje të të hyrave, detyrohemë ta fusim në rend dite përsëri, sepse komuna jonë ka sfidë të madhe kodin 22 (mjetet financiare që janë në kodin 22). Qeveria e Kosovës, duke e zbatur ligjin për buxhet, ka shpreh pozicion që t'i marrë të hyrat dhe në fakt i ka bllokuar të hyrat që gjenden në kodin 22. Komuna jonë, nga vendimi i mbledhje së kaluar e deri sot, i ka 58.000 euro më pak. Komuna e Prishtinës, 22 milion, e Suharekës, mbi 300.000. Ministria e Financave na ka detyruar që edhe një herë ta përsërisim vendimin dhe diskutimin rreth çështjes së bartjes. Pra, ne jemi të detyruar sepse është bllokuar vendimi për bartje të të hyrave për shkak se në mbledhjen e marsit e kemi votuar me 58.000 shtesë, mirëpo tani jemi të detyruar ta votojmë pa ato 58.000 euro dhe jemi të detyruar ta përmirësojmë vendimin, pastaj ne do ta vazhdojmë betejën ligjore për t'i zhbllokuar të hyrat që i ka bllokuar qeveria. E kemi bërë një reagim edhe si asociacion. Shpresojmë dhe jemi të bindur që edhe nëse shkon beteja ligjore në Gjykatë Kushtetuese, do ta fitojmë betejën.

**Bejtullah Deliu:** Faleminderit kryesues! Me kryetarin po keqkuptohemi rreth këtyre pikave. Vërejtja jonë ishte rreth asaj që në përgjithësi kemi mungesë të materialeve. Psh: Në këtë seancë nuk është kthyer nga MAPL- Plani i Punës i Komitetit për Shëndetësi, por mungon.

**Kryesuesi:** Faleminderit Bejtullah, kritikë me vend! Fillimi po filloj me dhënien e Betimit të kuvendares së re. E kemi këtu vendimin e KQZ-së, ku thehet që zonja Florida Bajraktari emërohet anëtare e kuvendit në Rahovec, nga subjekti politik PDK, duke e zëvendësuar anëtaren e kuvendit komunal, zonjën Ellma Hamza.

**Florida Bajraktari:** Faleminderit kryesues! Pershëndetje për ju, për kryetarin, drejtorët, kolegët. Unë, Florida Bajraktari, betohem që do t'i kryej me ndëri, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtare e kuvendit në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë.

**Kryesuesi:** Faleminderit Florida! Urime marrjen e mandatit ehe të urojmë suksese me punë të mira! Tani, po i vendosim në votim të katërtat pika shtesë për përfshirje në rend dite. Atëherë, kush është "për"?... Me shumicë votash përfshihen edhe këto pika në rend dite. Pika e dytë shtesë do të vendoset pas pikës së shtatë të rendit të ditës, për shkak të lidhshëmërisë, ndërsa tri të tjera do të jenë në fund. Atëherë, rendin e ditës me 15 pika gjithsej, po i vendosim që votim kush është "për"?... Me shumicë votash, miratohet rendi i ditës i seancës së rregullt për sot.

## 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

**Kryesuesi:** A ka diturë prej mëtarëve të kuvendit ndonjë gjë rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po i vendosim në votim, kush është "për"?... Me shumicë votash miratohet edhe procesverbalit i seancës së kaluar.

## 2. Pyetjet dhe përgjigjet në pvetjer e kuvendarëve;

**Fahrije Lushi:** Faleminderit kryesues! Inderuar kryetar, nënkyetar, kolegë këshilltarë. Shfrytëzoj rastin t'ia uroj koleges Floridë, mirë se erdhe dhe suksese. E kam një pyetje për kryetarin e që lidhet edhe me drejtorin e bujqësisë. Kur do t'i marrin pjesa tjetër e qytetarëve mjetet për dëmet e shkaktuara nga vërshimet?... Kam marrë disa ankesa prej qytetarëve në lidhje me këtë, kërkoj përgjigje nga kryetari.

**Rasim Fazliu:** Faleminderit kryesues! Desha ta ngris një çështje dhe konkretisht ta pyes kryetarin. Në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës, është debatuar mjaft çështja e tatimit në pronë dhe ministri i Financave ndoshta ka mundësi ta bëjë që tatimi në pronë të paguhet edhe këtë vit, njëjtë si në vitin e kaluar. Pyetja është, nëse keni marrë ndonjë iniciativë në këtë drejtim?...

**Edona Kryeziu:** Përshëndetje për të gjithë! Faleminderit inderuar kryesues! Inderuar kryetar, nënkyetar, drejtorë. Dua të flas lidhur me konkursen e fundit të shpallura nga Drejtoria e Arsimit. Konkursen e shpallura githmonë aludojnë në parti politike, të pranuar janë pjesë apo anëtarë të partisë në pushtet. Po ashtu, i të njëjtës parti është edhe paneli interviewues. Kërkojmë nga ju kryetar, si dhe nga drejtori i arsimit, që kjo strategji të mos përsëritet në konkursen e radhës. Kam edhe disa pyetje për ju drejtor. A është e vërtetë që disa mësimdhënës shëtiten nëpër shkolla?... Për një normë 20 orë në javë pranohen dy mësimdhënës. Në të gjitha konkursen që shpallojnë faqen e komunës, asnjëherë nuk ceket se ku do të punojë punëtori.... Kjo nënkupton që konkursi është i hapur formalisht, i punësuari është duke punuar. Pyetje e fundit: Deri kur të rinjtë e komunës sonë do t'i kenë të hapura dyert më shumë në Prishtinë dhe Prizren sesa në komunën e tyre?!

**Sinan Kryeziu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Po ndërlidhem me fshatin Xerxë, meqenëse vij nga aty. Në seancën e vitit të kaluar, pata ngritë si shqetësim që investohet pak në fshatin Xerxë. Pas Rahovecit, si qytet, Xerxa është tak sapaguesi më i madhi në komunën tonë. Brenda një viti, konsideroj që ka progres në investime. Është bëre shumë mirë në investimin e çerdhes për fëmijë, ka filluar investimi në shkollën "Hamëz Thaqi". Në një takim që pata me kryetarin e Xerxës, Arton Thaqi, u njoftova që kanë parashtruar një shkresë zyrtare me kërkesa e tyre drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kërkesa e tyre ka qenë të shtrohen 1200 metra rrugë me kubëza. Kryetari dhe drejtori i drejtorisë përkatëse ka aprovuar kërkësen e tyre dhe ata dëshirojnë ta dinë kohën se kur konkretisht do të fillojë investimi. Në maj të vitit 2022, në seancë e kam cekur që fshatarët e mi dëshirojnë të participojnë në trethoja për varret e fshatit dhe përsëri janë të të njëjtë mendim. Tjetër kërkësë që kam është ajo te rruga e "Flamurit" te salloni "Harley" i motorrave, është mirë të bëhet një kënd i lojërave për fëmijë, duke evitar rrëzikun, se është fëmijët vazhdojnë të luajnë në rrugë.

**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit inderuar kryesues! Inderuar ekzekutiv, kolegë, përfaqësues të KFOR-it, shoqërisë civile, qytetarë. Dua të lidhem pak me parafolëser nga radhët e LDK-së, Edona Kryeziu, se shkeljet në konkurse dhe procedura të rekrutimit janë permanentë. Është edhe vendimi i këshillit të pavarur mbikëqyrës. Në konkurs, kundërkandidati është ankuar dhe komuna e Rahovecit është obliguar ta zbatojë vendimin. Kundërkandidati në balë i ka plotësuar kriteret, z. Gani Kryeziu, me mbi 25 vjet përvojë pune, mirëpo këto kriterë nuk respektoher dhe në konkurse pranohen njerëzit që janë në të njëjtën vijë politike. Po ashtu, në vizitën që e kemi zhvilluar në QMF – Krushë të Madhe, personeli shëndetësor u ankua për kushte higjenike dhe sanitare. Si qëndron kontrata me mirëmbajtje dhe pastrim, sepse higjiena është parakusht për shëndet! Kjo QKMF funksionon me dy ndërrime, por, pastruesja aty qëndron vetëm paradite, si dhe kërkojmë sqarime pse kjo qendër nuk ka ende koordinator?...

**Vlora Vuçiterna Çmeqë:** Përshëndetje për të gjithë! Gjithashun edhe unë dua të ndërlidhem te vizita jonë në Krushë të Madhe. Kjo qendër, para një rruaji e ka fituar një donacion (aparat për analiza të gjakut, hemograt dhe analiza të urinës). Mirëpo, në mungesë të reagjentëve, këto aparate nuk janë në funksion. Pse po ndodh kjo? Përndryshe. QMF në Krushë të Madhe ka mungesë të barnave esenciale për fëmijë.

**Burim Krasniqi:** Faleminderit kryesues! Fillimi isht kam dy pyetje të ardhura nga qytetaret, njëra për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe të Bujqësisë bashkë, është Bedri Duraku, që e posedon një stallë në rrugën e Celinës, i cili

nkohet që ujërat atmosferike që rrjedhin i shkojnë komplet para stallës. Një propozim te rruga "Ibrahim Rugova" dhe rruga që shken kah stadiumi, meqenëse është bllokuar rruga kryesore, është mirë që kjo rrugë të bëhet dykahore, sepse kohë pas kohë kemi ngullatje në komunikacion. Sa i përket riparcelizimit të parcelave te sheshi, e kam thënë më herët që është mosaftësi e komunës të menaxhojë punë të mëdha, megjithatë nuk është shqetësuese, sepse për 5-6 ose 7 viteve deri sa të bëhet, sheshi edhe riparcelizimet bëhen, kalon edhe PZHK-ja edhe harta zonale, sepse në Rahovec, një projekt mund të zgjasë edhe 18-19 vite. Tjetër, që është shqetësuese, atë që e tha Edona dhe Lirigzoni po e vazhdoj edhe urë, e keni bë komunën si Pazar, si i "Malishevës" kur të bëhen ndërrime, duke blerë asambleistë, duke u premtojtar dhe e keqja më e madhe është që i premtohet vend pune në këmbim të pozitës së asambleistik. Kryetar, kjo është ekspozim i ndërrhyrjeve direkte që i bën me punësimë, është shkelje ligjore dhe nuk e di a është dikush që i përcjellë këto "pazare" që bëhen. Është turp dhe është shembulli më i keq që mund ta ketë një ekzekutiv. Ju bëj thirrje të gjitha organeve përgjegjëse që të merren seriozisht me këtë temë. Konkurset janë me ndërrhyrje direkte të kryetarit të Komunës dhe janë pazare direkte. Kemi edhe dëshmi me mesazhe të dërguara që "haide ti n'Aleancë se urë ta punësoj motrën, vëllain" me pazare të ndryshme. Boni numrat, nëse e shihai që politikat e Aleancës janë më të mira, atëherë pse mos me u bashkëngjit, por, pazaret me punësimë janë ndërrhyrje në konkurse. Kërkoi prej organeve përgjegjëse që të merren me këtë çështje, sepse kjo nuk mund të jetë pafundësish.

**Sejfullah Sejfullahu:** Mirë është ta rregulloni aparatin në QMI – në Krushë, ta funksionalizoni sa më shpejt. I kam dy çështje, njëra nga komuniteti i sportit dhe shfrytëzoj rastin përmes urim përmes dy fushat sportive të bëra, në Gexhë dhe Radostë. E përsëris përsëri, në Krushë të Madhe, ende nuk e kemi një të tillë, përkundër asaj që kemi banorë 4-5 herë më shumë se fshati Gexhë. Çështja tjetër, përmes kolektorin, përmes cilin është ndarë një buxhet dhe a do të fillohet me procedura të punës, me shpronësimë, sepse shumë vende i kanë të zgjidhura çështjet e kolektorëve të njësive të zezë, ne jemi në gjendje tmerri në Krushë.

**Hasan Përheq:** Faleminderit kryesues! Përvshëndetje kryetar, kryesues, kolegë asambleistë, drejtorë, media, shoqëri civile. E mora fjalën ta fitoj kryesuesin në ndërmjetësim që kolegët asambleistë ta ruajnë gjuhën që përdoret, një gjuhë që endueset ndaj asambleistëve. Nuk është mirë të ofendohet një asambleist, e në veçanti nëse i takon një partie tjeter. E kuptoj, është e dhimbshme kur një parti i ka 15 asambleistë, 3 partitë e tjera i kanë aq sa i kemi na vetë. Ju fitoi përmes 4 vjet, e jo t'i ofendoni të tjerrë. Përmes "pazare" mos të flasim, se Rahoveci është i vogël dhe secili e njohim njëri – tjeter. Në emër të 15 asambleistëve të Aleancës, nuk e durojmë këtë gjuhë diskriminuese dhe linquese.

**Kryesuesi:** Faleminderit Hasan, respekt përmes qëndrimin! Jam shumë i përgendruar gjatë seancave dhe reagoj gjithmonë kur ka shkelje të integritetit të antarëve të kuvendit. Në fjalimin paraprak nuk pashë diçka ofenduese, nëse ka ofendime, merru me ofendimin, sepse fjalimi yt ishte qëndrim politik dhe jo me çështjen në fjalë.

**Shqipe Kryeziu:** Faleminderit kryesues! Përvshëndetje kryetar, përvshëndetje përmes gjithë! Burim, prej që kam lindë as nuk jam shit as nuk jam ble, sepse më njeh me rrënjen. Viti i 16-të si profesorëshë dhe unë jam ndër ato që e kam ndërru subjektin politik. Kam qenë themelues e LVV-së në Rahovec dhe u ndiva shumë keq se nuk pata qejf që prej Burimit ia dëgjoj një gjë të tillë. Pjetja ime i përket Drejtorisë së Shërbimeve Publike: Në rrugen "Fadil Gashi në Fortesë", që disa ditë nuk është në funksion ndriçimi publik, nëse jeni në dijeni, kur do të evidentohet ky problem?...

**Burim Krasniqi:** Shqipe imë e thashë gjatë fjalimit, ai që ka bërë lëvizje politike, sepse ndihet mirë në atë subjekt politik, e pranoj. Por gjithashtu, është në rregull edhe që një pjesë janë me nazare. Në qoftëse dikush e ka bërë dhe e bën të ndihet keq, më vijë keq përmes secilin.

**Kryetari:** Përvshëndetje! Është një shkrimitar i njohur persian Saad-i (Saad Shiraz), i cili thotë: "I urti i rrahir me uthull me vaj, mendohet përparrë, hap gojën pastaj". Shkojnë me disa përgjigje që do t'i jap telegrafikisht: Shqetësimin me real që e ka ngritë në këtë kuvend, sot, është Fahrije Lushi! Është një fat i mirë që betejën përmes

kompensuar dënet në bujqësi nga 544, vetëm 60 prej tyre nuk mund të përfitojnë, të gjithë të tjerët po. Janë pranuar raportet dhe vendimi duhet të merret nga qeveria dhe shpresojmë që në një nga mbledhjet e ardhshme të qeverisë, të jetë në rend dite edhe miratimi i vendimit për kompensim me rastin e vërvimeve. Te Rasim Fazliu: Sa i përket tatimit në pronë, projektligji për tatimin në pronë është i sponsorizuar nga Ministria e Financave. Ministri janë i Financave, me gjasë ka bërë një gabim në momentin që ka menduar ta ekzekutojë vendimin pas rivlerësimit të pronave menjëherë, duke mos e analizuar aspektin ekonomiko - social të vendit. Ju e dini që kuvendet komunale kanë të drejtë të ndërhyjnë vetëm te norma tatimore dhe te në është shumë e ulët. Janë disa diskutime serioze që bëhen në qeveri dhe nuk dihet në janë të analizuara deri në fund, sepse kjo gjendje mund të sjellë pasoja në të gjitha komunat, sepse de faktë dhe de juro është vepër e Ministrisë së Financave. Sidoqoftë derisa projektligji ende është në diskutim për t'u bërë ligj, ne nuk mund të themi se është çështje e përsfunduar. Te vizita që është realizuar sot në QMF, në Krushë, nga Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe është e vertetë që kemi pranuar një donacion për QMF-në në Krushë, gjithashtu ndoshta është e vertetë që ka probleme me mirëmbajtje dhe higjenë, e kemi kompaninë e kontraktuar me vite për mirëmbajtje higjieno – sanitare, por, natyrisht që ne pranojmë edhe vërejtje, sepse mund të ketë mungesë të furnizimeve të materialeve për pastrim. Jam dakort që duhet të mirëmbahet higjera dhe duhet të funksionalizohen donacionet. Sa për dijeninë tuaj, për herë të parë, Komuna e Rahovecit ka fituar të drejtën të ndajë buxhet për barna esenciale dhe nëse mungojnë, atëherë duhet si paradoks. Te Sinan Kryeziu, këto ditë shumë pak operatorë kanë qënë në punë, kushtet klimatike nuk kanë qenë të përshtatshme dhe besoj që angazhimi i punëve do të tritet edhe në Xérxë, në rrugë me kuhëza dhe parqe. Te Lirigzon Kastrati: Të gjitha vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i respektojmë, sepse jemi të obliguar. Ai që e ka kaluar testin, i ka 27-28 pikë dhe askush nuk i ka faj që mund të ketë shumë diploma, kurse në test me qenë i dobët. Çështjet e ngritura vetëm që më kalitin më shumë, sepse të gjithë e njohim njëri - tjetrin se si dhe çka jemi në këtë vend, si jemi në raport me ligjin, sa kemi moral e ndershmëri dhe të gjitha prej A-ZH. Dikush i ftoi organet kompetente, unë do ta ftoj shefin e AKI-së, të merret me çështjen se kush-çka jemi. Tregtar dhe pazargji nuk kam qenë kurrë, le ta shikojë secili veten se ku punon, e ku është, e le t'i shikojë pazaret qendrore që janë bërë në nivel qendror e atë lokal. U rë zyret e hetuesisë ende nuk i di dhe gjithë jetën time që kam qenë nëpër burgje, kam qenë në atë të Serbisë, ose në të KFOR-it, për kauza që janë të ditura. Pazare me konkurse nuk ka të drejtë askush të bëjë, kush mendon as ka fakte. Le t'i drejtohen prokurorisë themelore në Gjakovë, Sektorit për Krime të Rënda në Gjakovë apo Prishtinë. Agjencisë Antikorrupsion dhe Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Këta që flasin kështu, jam i gatshëm të sfidhem me ta, sepse mund t'u bëj kallëzime penale. Pazare partiake nuk kam bërë kurrë, ata që flasin dinë t'i bëjnë më mirë, sepso i kanë bërë dhe ju tregoj se si i kanë bërë duke ju dhënë dosje. Të mos tentojë askush, t'ia tregojë detyrat e shtëpisë dikujt tjetër. Uroj që në këtë kuvendi të diskutohet thelbësisht për çështjet që janë në interes të qytetarëve. Odo konkurs hapet sipas ligjit, ka procedura dhe testim. Sa i përket pyetje së Sefës, është e vertetë që Krusha e Madhe është pa terren sportiv. Ne synojmë ta bëjmë një fushë sportive me standarde të larta, në afatin sa më të shpejtë të mundshëm. Sa i përket kolektorit, kolektori që është përmendor në kohën time, e në atë të Idrizit, kushton 20 milion euro. Aktualisht, bëhet fjalë për një kolektor tjetër, disa fonde prej grantit të performance-s i kemi nda për të. Do ta n'dërrojmë gypin në Krushë, Xérxë, Gexhë. Ralqoc e deri në Kramovik, sepse kemi probleme me qytetarë.

**Merisa Sharku:** Përshtendetje për të gjithë! Punimet në qendër të qytetit e kanë bllokuar rrugën dhe çasjen kryesore të qytetit, për të qarkulluar në atë pjesë, duhet zojedhar rrugët dytësore apo rrugicat e lagjeve. Problemi kryesor që bllokohet këto rrugë është mosbenjëzimi i tyre. Këtë punë që është dashur ta kryejë komuna apo operatori i kontraktuar, në njëfarë forme po e bëjnë qytetarët nëpër muret e shtëpisë me spreh të dorës. Kërkesa tjetër ka të bëjë me rrugën "Faik Ramë", kësaj lagjeje i mungen ndriçimi publik.

**Faton Ramadani:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë kolegët! Një pyetje për drejtorin e Financave sa i përket pagave të asambleistëve. Muajin e kaluar në listë figuronin 100 €, ndërsa në bankë zero - zero! Nëse ka mundësi për një përgjigje se sa është duke ndodhur kështu!

**Eqrem Spahiu:** Në seancën e parë të këtij viti, e pata ngritë një shqetësim lidhur me rrjetin e ujësjellisit që e kemi në fshatin Opterushë. E kemi një rrjet shumë të vjetër dhe intervenimet që bëhen aty, nuk mbulohen gropat pas përfundimit, një gropë e tillë është edhe para shtëpisë së drejtorit të Shërbimeve Publike. Të stërvjetër e kemi edhe rrjetin elektrik si dhë momentalisht, në Opterushë, shqetësim është mugesa e ujit të pijes, sepse reshjet atmosferike kanë shkaktuar edhe turbullimin e burimit

**Përparim Krasniqi:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Në Opterushë, ka vazhdimisht probleme me çështjen e ujit të pijes. E kemi dërguar dy projekte në Ministrinë e Ekonomisë dhe atë të Financave, projektet janë voluminoze dhe kalojnë shifren 2 milion €. Shpresojmë për një përgjigje pozitive dhe vitin e ardhshëm ta realizojmë projektin. Sa i përket gropave, është çështje e KRU-Gjakovës. Te pyetja e Merisës, rreth çështjes së punimeve në qendër besoi që është bërë një punë e shpejtë prej 1 muaji dhe tani është e qarkullueshme. Sa i përket ndriçimit publik, ende nuk kemi filluar me zëvendësimin e poqeve (ESCO), në momentin që fillojmë pas 15 majit, do të zëvendësohen edhe ato drita që janë mungesë.

**Bejtullah Deliu:** Faleminderit kryesues! Te punimet që janë duke u kryer prej Xhamisë Kadiri drejt rrugës "Përmeti", po krijohet një kanal, sidomos gjatë reshjeve atmosferike dhe pothuajse është e pakalueshme kjo rrugë. Mundësish, të bashkëbisedoni me operatorin, të bëhet diçka e përkohshme aty dhe të mos jetë rruga në atë gjendje.

**Përparim Krasniqi:** Kohët e fundit kemi pasë edhe të reshura atmosferike, ajo rrugë është afér finalizimit të punimeve dhe shpresojmë që të funksionalizohet kah fundi i majit.

**Afrim Limani:** Faleminderit kryesues! Te punimet që janë duke u kryer prej Xhamisë Kadiri drejt rrugës "Përmeti", po krijohet një kanal, sidomos gjatë reshjeve atmosferike dhe pothuajse është e pakalueshme kjo rrugë. Mundësish, të bashkëbisedoni me operatorin, të bëhet diçka e përkohshme aty dhe të mos jetë rruga në atë gjendje.

**Kryesuesi:** Faleminderit! Vazhdojmë me një pauzë deri në orën 13:00 ...

**Kryesuesi:** Fillimi më vije keq që nuk mund ta jepë një përgjigje të saktë, sepse akoma nuk e kemi një interpretim përfundimtar lejor. Shpresojmë që gjërat të definohen pas muajit prill.

**3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P- 71510057-02240-1, zona kadastrale - Rahovec;**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! I nderoar nënkyetar, të nderoar anëtarë të kuvendit. Para jush keni vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm pjesën e parcelës P- 71510057-02240-1, zona kadastrale – Rahovec (te Maja e Shkodranit) Bihet fjalë për pareclën me 75 ha e 74 ari e 1m katror, prej kësaj parcele ne kërkojmë nga ju që ta shpallim interes të përgjithshëm vetëm pjesën me sipërfaqe 2.5 ha.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! A ka dikush prej antëtarëve të kuvendit diçka për të thënë rreth kësaj pike? Nëse jo, atëherë po e vlerësojmë një votim, kush është "nëi"?... Me shumicë votash aprovohet pika e tretë e rendit të ditës.

**4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2022 në 2023;**

**Afrim Limani:** Faleminderit kryesues, kryetar, nënkyetar. Kjo pike në seancën e muajin shkurt ka kaluar, mirëpo, më prill, adresën time ka ardhë në email, që bartja e të hyrave vetanake nuk mund të procesohet më tutje, sepse, sipas ligj të buxhetit të vitit 2023, shuma e mjeteve nga kodi i të hyrave vetanake nuk mund të bartet. Ne jemi detyruar që ed një herë ta rikthejmë këtë pikë në këvend, duke e ndryshuar strukturën e projektit. Shuma totale që nuk mund të bar më tutje e që shkon në suricit, është 58.267 euro, nga totali që është 479.989. Në fund, shuma e bartur ngelet 421.7 euro. Projekti e propozuar mbetet, d.m.th. struktura mbetet e njëjtë, mirëpo, vlerën prej 58.267, jemi detyruar zbrasim.

(\*5 minitat në vazhdim janë shoqëruar me probleme teknike të zhrit në sallë, gjithashtu probleme teknike të video – incizimit.)

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve të kuvendit diçka për të thënë rreth kësaj pike? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”... Me shumicë votash aprovohet pika e katërt e rendit të ditës.

### 5. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim - ndryshimit të vendimit 01 Nr. 352/3, i datës 9.4.1986 mbi rivlerësimin dhe rikategorizimin e zonës së mbrojtur të “Kanioni i Drinit të Bardhë”;

**Afrim Oruqi:** Të nderuar anëtarë të kuvendit, para jush, sipas ligjeve në fuqi, keni një vendim shumë me rëndësi, i cili vë në mbrojtje disa parcela në zonën kadastrale në Gëxhë dhe Xërxë. Ky vendim, në të njëjtën kohë kur hyn në fuqi, do ta shfuqizojë një vendim paraprak të vjetër të vitit 1986 (9 prill). Para jush keni vendimin dhe një vlerësim profesional të një komisioni, i cili është formuar me vendim të vitit 2016. Ata kanë dalë në terren dhe kanë dhënë një arsyeshmëri për të dy zonat dhe për shkak të ekologjisë së këtyre zonave, ia kanë rekomanduar kuvendit të komunës zonat në duhet të janë me pjesët e mbrojtje (sipas ligjit që mbron natyrën). Në material, i keni të listuar numrat e parcelave, hartën dhe sipërfaqet e përgjithshme të tyre. Për zbatimin e masave dhe të kushteve të përaktuara, do të kujdeset Komuna e Rahovecit, përmes Drejtorisë së Urbanizmit. Me vendimin e ri, në bashkëpunim me ministrinë e linjës, zona e mbrojtur që do të mbrohet është 45 ha 62 ari e 59m katror, duke llogaritur dy zonat bashkë, Gexhën dhe Xërxën.

**Burim Krasniqi** ... Drejtor, rekomandoj që në mbrojte të Kanionit të Drinit të Bardhë të futen edhe këto parcela: 835-3, 835-5, 772-2, 772-3, 772-4, 772-5, 772-6, 772-8 deri 772-12. Edhe diçka te pjesa e vendimit, te pika 4.2 dhe 4.2, a e lejon komunën të bëjë veprime në të mirë të asaj zone<sup>9</sup>. Sepse, ndoshta neni 4, pika 4, e ngulfat shumë, a jemi në rregull sa i përket mundësisë që e lejon komunën në të ardhmen për intervenime në atë zonë!

**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! Sa i përket pyetjes së kuvendarit Burim Krasniqi: Jo rastësish, Sekretariati i Kuvendit ju ka ripërcjellë propozim-vendimin për shpalljen në mbrojtje të Kanionit të Drinit të Bardhë, sepse vazhdimi me zyrën ligjore të njëjtin vendim e kemi dërguar në ministri disa herë, për arsyen që mos ta kthejnë të kundërligjshme. Kanë kërkuar prej neve që të specifikojmë saktë se cilat parcela mbresin dhe cilat hiqen.

(\*4 minitat në vazhdim janë shoqëruar me probleme teknike të zhrit në sallë, gjithashtu probleme teknike të video – incizimit.)

**Burim Krasniqi:** Unë jam i mendimit që të përfshihen të gjitha parcelat në mbrojtje, le ta kthejnë vendimin edhe një herë dhe ta snobrim se ku jemi tutje. Është e palogjikshme, rdoshta edhe jam gabim por, më lë përshtypje si të ketë qëllime të caktuara nga komisioni.

**Afrim Oruqi:** Ky komision është në përbërje prej 7 anëtarëve, vetëm njëri prej këtyre ka qenë prej ekzekutivit të asaj kohe (Fehmi Hoxha). Të gjithë entarët kanë arsyetuar propozimin e vet me një hartë, foto dhe emërtime. Uroj që mos të jetë ashu si thotë Burimi. Ata e kanë vlerësuar kështu, duke thënë që ky është propozimi ynë, përndryshe vazhdini. Në kemi punuar në dy drejtime para se të kalojë PZHK-ja, edhe në Komosacion edhe në Zonën e Mbrojtur. Ndoshta qëllimi ynë është ta mbrojmë si zonë vetëm Urën e Shejtë, duke e ngushtuar territorin dhe duke e bërë zonë ndërtimore me qëllim të zhvillimit të asaj zone. Por, komisioni ka kërkesë me arsyeshmëri dhe duke e zbatuar ligjin

**Kryetari:** E falenderoj drejtorin për arsyetimet bukur profesionale që i bëri, njëkohësisht edhe vërejtjet e Burimit janë bukur interesante. Po e përmirësoj drejtorin ptk, nëse pytesh unë, a ish dashtë të mbrohet edhe Gradishi? Patjetër që po. Zona e mbrojtur mund të zgjelohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe duke bashkëpunuar me ministrinë. Nuk besoj që dikush, në atë kohë ka ndikuar në komision megjithëse nuk dyshoj që ka edhe interesa. Në qoftë se a vërbmbahemi specifikave në Zonën e Mbrojtur, ne si komunë mund të bëjni diçka me gurë ose dru (shteg të ecjes, agroturizëm), por nuk mund të bëjmë gjithçka. Te ajo pjesa ku foli Burimi, sidomos te kjo e Gradishit, ju e dini që aty kanë tentuar t'i bëjnë disa lokale, ne i kemi penguar disa veprimitari, sepse është zonë e

mbrojtur. Sa i përket komisionit, është përgjegjësi individuale. Në qoftë se ligjshmëria konfirmohet, atëherë ne mund ta shqyrtojmë pjesë-pjesë, diçka fusim në zonë të mbrojtur, ndonjë gjë mund ta heqim në të ardhmen, por gjithmonë në bashkëpunim. Shpresojmë që ligjshmërinë do ta kthejnë mirë dhe pas pak kohe mund ta vendosim përsëri në rend ditë për ndonjë plotësim – ndryshim.

**Rasim Fazliu:** E kam një kërkesë te drejtori, o drejtor i nderuar, a bon në projektor ta shohim të vendosur para se t'i grisim duart. Tregonë saktësisht cilat parcela futen, cilat jo, të shohim diçka dhe mos të flasim përmendësh.

**Afrim Oruqi:** I nderuar kuvendar, ka dy ditë që e kam bë gati një hartë me ngjyrë, sepse sot, me laptopët, sipas IT-së, janë në Drenoc Përndryshe, hartën e kemi bërë siç na ka kërkuar ministria, me ngjyrë të gjelbër, të kuqe dhe me ngjyrë pak më të cheksuar se e gjelbra. Sa i përket materialit, e keni fizikisht afër dhe i keni të gjitha arsyeshmëritë, si dhe të gjitha koordinatat që na ka propozuar ministria. Kërkujmë falje që për shkaqe teknike, nuk mund ta prezantojme në projektor.

**Kryesuesi:** Atëherë, përkundër të një rekomandimi nga Burimi, por për shkak të diskutimeve të shumta rrëth kësaj pike, propozimin po e vendosim si të illë në votim! Kush është “për”... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, kemi 15 vota “për” dhe 6 vota abstenim dhe kalon plotësim-ndyshimi i këtij vendimi.

#### **6. Shqyrtimi i raportit tre - mujor finansiar, janar - mars 2023;**

**Afrim Limani:** Përsbëndeje edhe një herë! Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ka arritur që me kohë ta përgatisë këtë raport 3 - mujor finansiar edhe pse janë disa data që vonohen për shkak të barazimit me Ministrinë e Financave. Ky raport përböhët nga dy pjesë, pjesa e të hyrave dhe pjesa e shpenzimeve. Të hyrat e rregullta për këtë 3 - mujor, kanë qenë 358.958 € dhe nëse e bëjmë një krahasin me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi diferençë pozitive prej 103.677 €. Shpenzimi i buxhetit për këtë 3 - mujor është shpenzuar 25.27% ose 4.436.442 €, prej tyre 23.17% janë investime kapitale, subvencione 16.17%, komunali 31.38 %, mallra dhe shërbime 21.66%, paga dhe mëditje 26.32%.

**Burim Krasniqi:** Falenderit kryesues, falenderit drejtor! Tabela 1.2, te faqe 3, kolona 1,2,3, te përqindja është gabim komplekt, nëse ka qenë planifikimi 120.000 e shpenzimi 102.000 dhe nuk i bie 14.58%. Te tabela 1.4 te gjobat the që nuk i kam rezultatet mirëpo te kolona e fundit, nuk mund të vendoset realizimi kur tabelat janë 00, d.m.th kolona e fundit është gabim. Te tabela 1.6, te tatami në prene: në 2023 realizimi është 202.588.46 € dhe në qoftëse e krahasojnë me tabelën 1.2 komplekt realizimi është 102.000 dhe nuk mund të jetë 202.000. Te pjesëmarja në tender e keni 00, nuk ka pasë hiç? Apo janë të liruar taksës?... Dhe legalizimet e objekteve, sigurisht nuk ka pasë këtë vit është 00. Te qeraja është 00, a nuk e kemi asnjë objekt të përkohshëm që është me qera?... Tabela 2.1 planifikimi dhe realizimi i tatimit në pronë për vitin 2022-2023: Nëse i shikojmë të realizuarat e të hyrave nga tatimi në pronë, në faqe 6, është 358.958 €, në anën tjetër te tabela 2.1 të gjitha të hyrat janë në këtë vlerë, është gabim përsëri sense tatami në pronë duhet të jetë shumë më i vogël sepse ka të hyra të tjera që nuk janë të përfshira. Te tabela 2.2 në të njejtën faqe, te regjistrimi dhe verifikimi i objekteve të tatimit në pronë sipas këtij rapporti, 2022-a e përfshinë gjithë vitin apo vetëm tre-ravjorshin?... Në reportin vjetor i keni pasë 371 objekte, jo 90, krahasoje dhe e vëren që nuk është në rregull. Në faqe 7, tabela 3.1 pozicioni grante: Shpenzimet janë 160.000€, kurse në buxhetin e aprojuar nuk është askund ky pozicion i graait, a lejohet ky pozicion nëse nuk është i planifikuar?... Te tabela 3.3 e kam një pyetje dhe nuk pres që sot të përgjigjesh: P.sh, shpenzimet në antarësim (besej që antarësimi duhet me qenë në asocierjen e komunave të Kosovës) në vitin 2023 janë 9000€! Te administrata, te nafta për ngrohje qëndrore në vitin e kaluar kanë qenë 2833€, sivjet janë 11.444€, përkundër asaj që është rritur qumë i naftës, kemi një rritje prej 500%. Te zyra e kryetarit, kemi një rritje prej 100% të shpenzimeve prej 10.000 sa ka qenë, i kemi gati 22.000€, i kemi disa pozicione te punët inspektuese, thotë: Dru 1676€, a përdoren dru zërrfikësat që e kanë bërë këtë shpenzim?... Te mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe te mirëmbajtja rrujore, vitin e kaluar kemi pasur 29.000 shpenzime, sivjet i kemi 101.000€ vetëm në 3 mujorshin e parë (rritje 50%).

Të mirëmbajtja rutinore, në 2022 ka qenë 00, 2023 janë 20.235€. Shfrytëzime të ndryshme shëndetësore, vitin e kaluar nuk kemi pasë hiç, sivjet i keni 9767€. Shërbime kontraktuese tjera, vitin e kaluar kanë qenë 693€, ndërsa sivjet janë 36.300€. Te Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale, vitin e kaluar kemi pasë 1080€ shpenzime për dru, ndërsa sivjet kemi 11.426€ (rriti prej 1000%). Drejtor, mendoj që në seancën e radhës i përmirësuar nga këto gabime që duken teknike sepse në fund tabelat dalin të palogjikshme.

**Afrim Limani:** Burim, nuk e përjashtoj mundësinë që kemi bë gabime teknike. Nuk e përjashtoj atë mundësi që edhe formula e kalkulimit ka qenë gabim. Te të hyrat në tatumin në pronë, janë saktë 202.850€, në tabelë tjetër e kemi bërë një gabim d.m.th nuk qëndron kjo shumë 358. Pyetja tjetër ishte rrëth donacioneve, edhe pse je një njohësi i mirë i cështjeve të caktuara ekonomike, por, përsëri ja huq. Donacioni apo granti i fituar mund të bartet në vitin tjetër vijues dhe këto janë grante që nuk i kemi shpenzuar dhe i kemi bartur nga viti 2022 në 2023. E përmende rastin te shpenzimi i buxhetit te zyra e kryetarit që është rritur 100%, buxheti është shpenzuar sipas planit dhe dinamikës dhe shumë herë ndodh që në fund të një viti fiskal nuk mund t'i mbulojmë të gjitha faturat, mirëpo në viti e ri fiskal kemi arritur t'i mbulojmë faturat e mbetur. Te shërbimet kontraktuese tjera, ne i kemi shumë pagesa që bëhen në kuadër të këtij kodi ekonomik. Te shpenzimet për anëtarësim, e kemi paguar asociacionin e komunave dhe marrëveshjet e parteritetit.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! A ka edhe dikush tjetër diçka për të thënë?... Nëse jo, e kalojmë këtë pikë meqenëse është vetëm shqyrtim i raportit dhe nuk votohet.

#### **7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë P- P-71510008-00266-0, në zonën kadastrale Hoçë e Madhe:**

**Erhan Morina:** Faleminderit kryesues! Inderuar nënkyetar, kolegë, anëtarë të kuvendit. Para jush keni materialin për dhënen në shfrytëzim të pronës komunale në periudhë afatgjate deri në 25 vite, përmes procedurës së shprehjes së interesit. Prona e palujtshme gjendet në Hoçë të Madhe dhe është kulturë e kullosës së gjashtë me sipërfaqe të përgjithshme 10.099m katror. Çmimi tillestar i pronës komunale duke përfshirë zyre administrative do të jetë 550€.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! A ka edhe dikush tjetër diçka për të thënë rrëth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim! Kush është "për"?... Me shumicë unanimë, miratohet pika e shtatë.

#### **8. Shqyrtimi dhe miratimi i venditait për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënicës në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës;**

**Erhan Morina:** Kjo pikë ndërlidhet me pikën paraprake. Kërkohet formimi i komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të parcelës në fjalë. Komisioni përbëhet prej pesë anëtarëve, 2 prej kuvendit, 2 nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile.

**Kryesuesi:** Atëherë, dy anëtarë do të delegohen prej kuvendit në këtë komision. I ftoj grupet e asambleistëve për propozimet e tyre, nëse ka më shumë se dy propozime, atëherë do t'i vendosim në votim.

**Hasan Përboqi:** AAK, propozojmë Feriz Thaqin

**Merisa Sharku:** LVV, nuk kemi propozim.

**Edonë Kryeziu:** PDK, propozojmë Lirigon Kastratin.

**Sejfullah Sejfullahu:** PDK, propozojmë dr. Armir Vuqitëma.

**Kryesuesi:** Atëherë, meqenëse kemi 3 propozime, po i vendosim në votim! Kush është "për" Feriz Thaqin?... Lirigon Kastratin?... Armir Vuqitëma?... Atëherë, dy anëtarët më të votuar janë, Feriz Thaqi, 15 vota (AAK) dhe Armir Vuqitëma, 17 vota (PDK). Me këtë përbërje po e vendosim në votum! Kush është "për"?... Me shumicë unanimë, aprovohet edhe pika e tetë e rendit të ditës.

#### **9. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;**

**Vlora Vuçitëma Çmega:** Faleminderit! Inderuar kryesues, nënkyetar, kolegë asambleistë, drejtorë të drejtorive. Në pajtim me udhëzimin administrativ Nr.05/2020 për procedarën e themelimin të komiteteteve të përhershme dhe

komiteteve tjera në komunë, kuvendit të komunës ia dorëzojmë planin e veprimit të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për 2023. Ky komitet gjatë muajve në vijim ka planifikuar t'i ndajë këto takime: Vizitë në QMF – Krushë e Madhe, vizitë në QMF – Xërxe, në Ratkoc, në AMF – Rahovec, takim me këshillin e pacientëve në Rahovec dhe përgatitja e raportit të komitetit. Të gjitha sugjerimet që i marrim nga këto vizita, do t'i adresojmë te Drejtoria e Shëndetësisë, duke punuar gjithmonë në të mirë të banorëve të komunës sonë.

**Kryesuesi:** Ky plan i veprimit sipas procedurave duhet të kaloj formalisht. Po e vendosim në votim, kush është “për”... Me shumicë votash aprovohet edhe plani i veprimit i Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

#### **10. Shqyrtimi dhe miratimi i planit komunal të veprimit për Riintegrin e Qëndrueshmë të Personave të Riatdhesuar dhe Integrin e të Huajve në Komunën e Rahovecit;**

**Nënkryetari:** Faléminderit i nderuar kryesues! Të ndërmarr asamblesitë, drejtore, të gjithë të pranishëm. Në mungesë të përlaqësuesit të ZKKK-së, po e prezantoj unë. Pari vetes e kemi Planin Komunal për Riintegrin e Qëndrueshmë të Personave të Riatdhesuar, me 10 objektiva, si dhe me të gjitha masat e parapara për arritjen e këtyre objektivave. Nuk dua ta zgjasë më tepër, nëse keni diçka për ta pasuar këtë plan?!

**Kryesuesi:** Faléminderit nënkryetar! Besoj që materialin e kanë të gjithë anëtarët e kuvendit, nëse dikush prej tyre ka diçka për të thënë?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”... Me shumicë unanim miratohet pika e dhjetë.

#### **11. Shqyrtimi i raportit finansiar buxhetor i NPL – Stacioni i Autobusëve – Rahovec;**

**Përparim Krasniqi:** Në cilësinë e kryesuesit të ndërmarrjes komunale Stacioni i Autobusëve – Rahovec, pas kthimit të ligjshmërisë, kemi silluar dhe përfunduar procedurat e zgiedhjes së anëtarëve të bordit të kësaj ndërmarrjeje. Anëtarët e bordit e kanë përgatitur raportin finansiar që e keni ju si material. Deri më tanë, i kemi mbajtur 8 takime, 6 prej tyre në vitin 2022.

**Burim Krasniqi:** Tendencia për ta nxjerrë nga kriza financiare Stacionin e Autobusëve, me rritje të çmimit, për mua është e nalogjikshme, duke pasur pàrsash gjendjen që e kanë kluar kompaniën transportuese gjatë periudhës së pandemisë qhc gjatë faza së ngritjes së çmimit të naftës. E kemi një botxh të akumuluar prej vitit 2000 (10.753€), i cili përfshin tatum rë pronë dhe taksa komunale. Besoj që edhe këto janë të përfshira në vendimin e faljes së borxheve! Drejtore, shikojeni mundësinë e subvencionimit të Stacionit të Autobusave, sepse nëse subvencionohet 10.000€ më vit, do të ketë performimi finansiar në rregull. Përndrysje, mund të ketë vështirësi financiare, sepse pagat e punëtorëve janë të vogla dhe mund të ndodh rrij situatë kur punëtorët e lëshojnë punën dhe nuk mund t'i kthejmë cas. Diskutoeni edhe me kryetarin sepse nuk është shumë e madhe mbulimi i shumës prej 10.753€, them kështu sepse me ligjin i ri për financa mundeson të ndarje të buxhetit për subvencionim.

**Përparim Krasniqi:** Faléminderit Burim! Stacioni i Autobusave, ndoshta për shkak të këtij komisioni që jemi tanë, ka shpëtuar edhe nga falimentimi. Komuna e Rahovecit ka marrë përsipër 100.000€, duke bërë pagesë për takṣë, sepse nuk e kam shifrat e zvogëluar të drejtën e faljes së borxheve në 2018, kjo i bie që ka qenë një stacion me menaxhment të dobët. Komuna e Rahovecit ka bërë renovimin e tërësishëm të stacionit dhe është duke ndërtuar 8 lokale afariste qhc besoj që shumë shpejt do të hyjnë në funksion edhe si takṣë, duke ndikuar në rritjen e performancës së tyre.

**Burim Krasniqi:** Drejtore, nuk e körtestova qështjen e performimit të grupit të aksionarëve. Në momentin që ka mospajtim në mes transportuesëve dhc stacionit, çmimin e vendosë Ministria e Ambëtentit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - Departamenti i Transportit. Nuk e vendosë bordi, bordi vetëm rekomandon dhe këtë e them me përgjegjësi profesionale.

**Kryesuesi:** Faléminderit Burim! Nëse edhe dikush tjetër nuk ka ndonjë gjë për diskutim, po kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës

#### **12. Shqyrtimi i raportit të punës trt - mujore të KRM – Koregjioni;**

**Përparim Krasniqi:** Në krahasim me Stacionin e Autobusëve, kjo ndërmarrje finansiarisht qëndron më mirë. Këtu jemi tre anëtarë, 2 janë prej kuvendit: Sinan Kryeziu dhe Sejfullah Sejfullahu. Edhe pse me vendim të kuvendit të kemi 6 takime, ne i kemi mbajtur 7.

**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit kryesues! Kolegë anëtarë, ekzekutiv. Sa i përket këtij raporti, në këtë njësi menaxhon Ekoregjioni –Prizren. Problemi qëndron në atë se Komuna e Rahovecit çfarë masa ka ndërmarrë në përmirësimin e ambientit në komunën tonë. Nga lokaliteti që jam, banorët kanë bërë disa kërkesa për pastrimin e disa mbeturinave, gjë që nuk ka ndodhur deri tash. Nëse mund të na tregojë drejtori se si qëndron gjendja e ambientit në komunë, si menaxhohet? ..

**Përparim Krasniqi:** Komuna e Rahovecit ka përqindje në KRM – Ekoregjioni (8%) dhe shumica e aseteve që i ka njësia në Rahovec, janë pjesë e komunës. Në nivel vendi, jemi komuna që ka më pak deponi ilegale. Për shkak të performancës së mirë në këtë drejtim, së fundi ka fituar një kamion në vlerë prej 156.000€.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Nëse edhe dikush tjetër nuk ka ndonjë gjë për diskutim, po kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës.

**13. Shfuqizimi i vendimit 01 Nr.48/23 dt. 30.3.2023 për ripareclizim të parcelave në zonën kadastrale - Rahovec;**

**Kryesuesi:** Gjatë diskutiimeve të bëra më herët, e sqaruam arsyen se pse këto pika janë në rend dite. Kështu që, po e vendosim në votim për shfuqizim! Kush është "për"?... Me shumicë votash, shfuqizohet vendimi Nr.48/23.

**14. Shfuqizimi i vendimit 01 Nr.54/23 dt. 30.3.2023 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit të fshatit Kramovik;**

**Kryesuesi –** Kush është "për" shfuqizimin e këtij vendimi?... Me shumicë votash, shfuqizohet edhe ky vendim.

**15. Shfuqizimi i vendimit 01 Nr.55/23 dt. 30.3.2023 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë.**

**Kryesuesi:** Kush është "për" shfuqizimin e këtij vendimi?... Me shumicë votash, shfuqizohet edhe ky vendim dhe me këtë pikë po e përmbyllim scancën për sot. Mirëmbetshi!

Prizreni, 15.04.2023  
Alijan Krasniqi  


